

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Kymete Kicaj dhe Artan Sejrani, me procesmbajtësen Ardiana Reshtani, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.M. nga ..... dhe R.M. nga ..... për shak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.323/15 të datës 08.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tyre av. B.S. dhe B.N. ,më datën 03.04.2017 muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

### Të akuzuarit:

**N.M.**, nga i ati Q. dhe e ëma F. – e lindur Q. , i lindur më (i lindur me daten...) në fshatin ..... , me banim në ..... rruga “.....” nr. ... , e ka të kryer fakultetin e arkitekturës, inspektor i ndërtimtarisë, i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**R.M.** , nga i ati I. dhe e ëma A. – e lindur P. , i lindur më (i lindur me daten...) në ..... ku edhe tani banon në Lagjen “.....” rruga “ .. .... ” Lamela . / .. , inzhinier i ndërtimtarisë, i martuar – i ati i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konformë nenit 364 par.1.p.l.3, të KPP i akuzuari N. M.

## LIROHET NGA AKUZA

Se si person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk i përmbush detyrat zyrtare me qëllim që të përfiton çfarëdo dobie për personin tjetër apo që ti shkakton dëm personit tjetër, në atë mënyrë që në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë komunale të inspektorateve të Prizrenit, pasiqë del në vend të ngjarjes më datën 06.08.2015 në rrugën e “.....” nr. . , në ..... , nuk i ndërmerr masat konkrete

të detyrueshme ligjore për ndërprerjen e rrënimit të objektit të vjetër "H. i M." derisa të sigurohet leja për rrënim ashtu si figuron në urdhëresën e procesverbalit për inspektimin e kryer me nr.serik ..... të datës 06.08.2015, por përkundrazi mjaftohet në sugjerimin që mbeturinat e objektit të transportohen në deponinë e qytetit ku për pasoj më datën 06.08.2015 investitori i ri A.B. përveç shtëpisë, pas kontrollit vazhdon dhe e përfundon rrënimin e objektit të ashtuquajtur "H. i familjes M.", në rrugën e "....." nr. 6 , në ..... i cili ka qenë i përfshirë në rubrikën l3, të shtojcës nr.II të listës së trashigimisë kulturore për Qendrën historike të Prizrenit, me ç rast përveq që është dëmtuar kujtesa kolektive e qytetit, njëherit është dëmtuar edhe trashigimia kulturore e arkitektonike e mbikëqyrur nga Zyra e Qendrës historike të Prizrenit.

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 pr.l. të KP.

Konformë nenit 364 par.1.p.l.3, të KPP i akuzuari R. M.

### **LIROHET NGA AKUZA**

Se si person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie personit tjetër por që njëherit ti shkaktoj dëm personit tjetër në atë mënyrë që në cilësinë e bashkëpunëtorit profesional në Drejtorinë e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor të Komunës së Prizrenit i ngarkuar me lëndën e investitorit Sh.M. me nr. .. - ... - ..... - .. / .. / .. të datës 05.12.2014, për dhënjen e pëlqimit për rrënimin e objektit "H. i M." në rrugën e "....." në ..... , nuk ka vepruar në përputhje me nenin l6 par.6 e lidhur me nenin l8 par.l. të Ligjit nr.04/L-066 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 18.07.2012 për Qendrën historike të Prizrenit që edhe përkundër mungesës së pëlqimit të Këshillit komunal të trashigimisë kulturore të Prizrenit nuk i është përgjigjur kërkesës së investitorit Sh.M. që të përpiloj aktvendim për projekt të lejes për rrënim ose refuzim të kërkesës, ku për pasoj më datën 06.08.2015 investitori i ri A.B. përveç shtëpisë e rrënon edhe H. e familjes M. të cilin vend tani e shfrytëzon për parking dhe realizon të ardhura, i cili objekt ka qenë i përfshirë në rubrikën l3 të shtojcës nr. 2, të listës për trashigimi kulturore të Qendrës historike të Prizrenit, ku në njerën anë është dëmtuar kujtesa kolektive e qytetit, e njëherit është dëmtuar edhe trashigimia kulturore e artitektonike e mbikëqyrur nga Zyra e Qendrës historike të Prizrenit.

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. të KP.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **Arsyetim**

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda, kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP.nr.323/15 të datës 08.07.2016 kundër të akuzuarit N.M. nga ..... për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. të KP dhe R.M. nga ..... për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.l. të KP. Gjatë fjalës përfundimtare Prokurori i Shtetit Metush Biraj ka theksuar se nga provat e administruara në këtë gjykim, ato materiale dhe deklaratave të dëshmitarëve padyshim është vërtetuar se i akuzuari R.M. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar pasiqë sipas nenit 16 par.l. ka qenë i obliguar që njëkohësisht qoftë Institutit për mbrotjen e monumenteve të Prizrenit dhe Këshillit për trashigimi kulture në Prizren të iu dërgoi nga një kopje për leje për rrënim, dhe bazuar në nenin 18 par.l. të këtij ligji ka qenë i obliguar që të procedoi për lëshim të lejes, qoftë për rrënim apo mos rrënim. Ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Poashtu sa i përket të akuzuarit N.M. ka cekur se nga vet deklarata e të akuzuarit vërtetohet fakti se me daljen në vendin e ngjarjes më datën 06.08.2015 në rrugën e “.....” nr. . në ..... nuk e përmbush detyrën e tij zyrtare si inspektor i ndërtimtarsë dhe në përputhje me urdhërin si në procesverbalin ..... të datës 06.08.2015 nuk merr masa konkrete për ndërprerjen e rrënimin të objektit të hanit derisa investuesi të siguroi leje përkatëse dhe se lejon që një pjesë e mbeturinave nga objekti i rrënuar të transportohet jashtë qytetit, në vend se aty të vendos shiritin në funksion të zbatimit të urdhërit e pastaj të nxjerr edhe aktvendim për fuqizimin e urdhërit nga procesverbali i vendit të ngjarjes. Ka propozur që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M. avokat B.S. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara me asnjë provë nuk është vërtetuar që N.M. ta ketë kryer veprën penale ashtu siq përshkruhet në aktakuzë, andaj ka propozuar që në mungesë të provave gjykata të merr aktgjykim lirues.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.M. , avokat B.N. ka theksuar se nga konstatimet e paraqitura në akuzë si dhe ato të paraqitura në fjalën përfundimtare nga ana e Prokurorit të shtetit pretendohet se ky objekt të ketë statusin e monumenteve të mbrojtura të trashigimisë kulturore. Mirëpo, provat të cilat janë në shkresat e lëndës dhe konstatimet e kompetentëve për statusin e këtij objekti, pra të QRTK-Prizren por edhe nga vet lista me të cilën pretendon të bazohet aktakuza pamëdyshje del se ky objekt nuk është pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe paraprakisht nuk ka qenë i propozuar. Ky konstatim është i

theksuar me provën që gjendet në shkresat e lëndës dhe që është nënshkruar nga drejtori i QRTK më datën 10.04.2015. Për të qenë pjesë përbërëse e listës së trashigimisë kulturore duhet të plotësohen disa norma dhe se këto norma janë të ndryshueshme dhe lista e tillë nuk është e përhershme. Andaj, në bazë të lartëcekurave ka propozuar që trupi gjykues të merr aktgjykim lirues, me çka është pajtuar edhe vet i akuzuari duke shtuar se me provat e administruara në tërësi është vërtetuar se është i pafajshëm.

Në rastin konkret nuk është kontestuese fakti se “H. i M.” është rënë, mirëpo kontestuese është se “hani” në fjalë a ka qenë pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe se këtu të akuzuarit me veprimet e veta a e kanë kryer veprën penale për të cilën edhe janë akuzuar.

Andaj, në këtë drejtim, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë procedurës së provave ka ndëgjuar dëshmitarin N. M.1 i cili në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.11.2016 ka deklaruar se fare nuk kanë parashtruar kërkesë për leje për rrënimin e objektit pasi që ka qenë muaji nëntor apo dhjetor i vitit 2014 mirëpo, të njëjtin e ka lajmëruar axha Sh. M. që të lajmërohen në Drejtoratin e inspektionit sepse ka mbërritur një ftesë apo kërkesë për rënimin e objektit nga inspektioni i Kuvendit komunal. Edhe ai vet ka qenë i befasuar për urdhëresën e inspektionit komunal për rënimin e objektit dhe se aty një inspektore, me emrin D. , i ka thënë se brenda dy jave objekti duhet të rënohet sepse rrezikon jetën e kalimtarëve dhe se objekti ka qenë gjysëm i rrënuar nga ana e prapme e rrugës, kulmi dhe muret kanë pas ra, vetëm ekzistonin dërrasat dhe se kishte rrezik nga rrënimi. Më pastaj ka shtuar se kanë aplikuar për marrjen e lejes për rënim në urbanizëm mirëpo, kanë pritur më pas përgjigje nga drejtorja për mbrojtjen e monumenteve dhe trashigiminë kulturore dhe pastaj kur është interesuar në entin për mbrojtjen e monumenteve historike se çka është bërë në këtë rast, ata i kanë thënë se rasti duhet të dërgohet në Prishtinë në Ministrinë e kulturës së pari ata të japin leje, e pastaj lënda përsëri kthehet tek ata dhe se ata japin leje kur e miraton ministria. Mirëpo, rasti ka zgjat mbi 5 muaj dhe pas 5 muajve prej Entit të monumenteve është lajmëruar se është pranuar kërkesa për marrjen e lejes për rrënim dhe se edhe Enti për mbrojtjen e monumenteve historike në Prizren ka dhënë leje për rrënim. Mirëpo, në ndërkohë shtëpinë e kanë shitur dhe se të gjithë dokumentacionin ia kanë dorëzuar blerësit.

Poashtu në procesverbalin e shqyrtimit të njëjtë është ndëgjuar edhe dëshmitari V.H. – kryesues i Këshillit komunal të trashigimisë kulturore prej korrikut të vitit 2015 deri më 10.gusht.2015 i cili ka deklaruar se kompetenca e Këshillit për trashigimi kulturore ka qenë që lëndët e ardhura nga Drejtorja e urbanizmit të cilat janë në Zonën e Qendrës historike ti shqyrtoi dhe të jep këshilla – rekomandime në lidhje me lëndën që vjen prej urbanizmit.Zakonisht pranimi i lëndëve deri një kohë kur nuk kishte zyre është bërë në atë mënyrë duke shkuar në urbanizëm dhe duke i marrë lëndët, e pas kësaj lëndët kanë ardhur në zyre të këshillit nëpërmjet dorëzuesit. Sa i përket lëndës së familjes M. të njëjtën e ka pranuar nëpërmjet postës elektronike me datën 21.korrik.2015, mirëpo, lënda e cila

fizikisht ishte në zyrën e këshillit nuk ka patur vulë dhe nënshkrim – ajo lëndë që ka ardhur nëpërmjet dorëzuesit nuk e ka patur vulën e pranimit prej Drejtorisë së urbanizmit e cila zakonisht ka ekzistuar tek lëndët tjera dhe se te kjo lëndë ka munguar vula dhe nënshkrimi. Për këtë arsye edhe i ka thënë administratores së këshillit që të mos ta pranoi këtë lëndë pa vulë dhe nënshkrim pasiqë nuk është zyrtare. Në lidhje me këtë lëndë nuk është dhënë kurrfarë përgjigje pasiqë ditën kur është mbajtur mbledhja e këshillit, ku edhe duhej që të shqyrtohej edhe kjo lëndë, në fakt më nuk ka ekzistuar “H. i M.” pasi që atë ditë është rënuar. Mëtej ka shtuar se diskutim nuk ka pas, mbledhja nuk është mbajtur dhe se pas 4 ditëve ka dhënë dorëheqje dhe nuk din më asgjë lidhur me rastin.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.01.2017 është deklaruar edhe dëshmitari M.K. i cili ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori duke shtuar që prej vitit 2003 punon si bashkpunëtor profesional për çështje juridike në Drejtorinë e urbanizmit në Prizren. Ka njohuri që Ligji mbi qendrën historike të Prizrenit ka hyrë në fuqi në vitin 2012 dhe se në bazë të këtij ligji zyrtari përgjegjës i Drejtorisë për urbanizëm i caktuar për lëndën, në momentin e pranimit të lëndës në afatin sa më të shpejtë të mundshëm lëndën e përcjellë në Këshillin për trashigiminë kulturore dhe Qendrën rajonale të trashigimisë kulturore në Prizren dhe se pa pëlqimet e tyre – rekomandimet i njëjti si jurist nuk ka lëshuar ndonjë leje ose refuzuar ndonjë kërkesë dhe se rasti i dy kolegëve të tij – tani këtu të akuzuarëve ka qenë kryekëput pritja nga këshilli për trashigimi kulturore e cila në atë kohë ka qenë jo funksionale. Objekti i akuzës është në shtojcat e ligjit për qendrën historike mirëpo, nuk e din se objekti i njëjtë a është i rregjistruar edhe si objekt në ministrinë përkatëse.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.02.2017 dëshmitarja Gj.B. ka theksuar se në prill të vitit 2015 është punësuar si praktikante në Këshillin për trashigimi kulturore ku edhe ka punuar gjithësejt 6 muaj në cilësi të administratores. Detyrat e saja kanë qenë pranimi i lëndëve, skenimi dhe dërgimi në E-mail të anëtarëve të këshillit dhe të kryetarit të këshillit për trashigiminë kulturore. I kujtohet që ka ardhur edhe lënda e Sh.M. që të shqyrtohet në këshill, konkretisht për objektin “H. i M.”, mirëpo, lënda në fjalë ka qenë e pavulosur. Lënda ka ardhë atë ditë kur nuk ka qenë në zyre dhe se për këtë arsye është lënë në bife, pastaj kur është kthyer i ka marrë lëndët me ç rast edhe ka vërejtur se kjo kërkesë është e pavulosur. Pasiqë kjo lëndë ka ardhë së bashku me lëndët tjera e ka bërë procedurën e njëjtë, ka bërë skenimin dhe ia ka dërguar lëndën anëtarëve dhe kryetarit të këshillit dhe e ka lajmëruar kryetarin e këshillit se kjo lëndë është e pavulosur dhe kështu nuk ka ndodhur asnjëherë më parë. Poashtu, i kujtohet se kryetari i këshillit i ka thënë se nuk do ta shqyrtoi këtë lëndë pasiqë nuk është e vulosur.

Nga aktvendimi i Inspektoratit komunal i Drejtorisë së inspektorateve të Komunës së Prizrenit me nr. .. - ... / ..... të datës 26.11.2014 vërtetohet se i është urdhëruar Sh.M. dhe bashkëpronarëve të tjerë që në afatin prej 15 ditëve ta bëjnë rrënimin e tërësishëm të objektit-hanit të vjetër për shkak të amortizimit të objektit, se është gjysëm i rrënuar dhe se paraqet rrezik për kalimtarët e rastit dhe

banorët fqinj.Poashtu në të njëjtin aktvendim ceket se në të kundërtën do të pasoj ekzekutimi i detyrueshëm.

Nga procesverbali për inspektimin e kryer të datës 06.08.2015 vërtetohet se inspektori N.M. dhe A.B. me datën 06.08.2015 në ora 15:30 minuta kanë urdhëruar ndërprerjen e punimeve në rënimin e objektit të vjetër” H. i M.”.

Nga urdhëresa për pagesë e datës 06.08.2015 vërtetohet se A.B. është ndëshkuar me gjobë mandatore për rënimin e objektit pasi që nuk është pajisur me leje të rrënit.

Nga kërkesa për dhënje të përgjigjes për rrënim e DUPH me nr. .. - ... - ..... e datës 05.12.2014, vërtetohet se është dërguar kërkesa për dhënjen e pëlqimit për rrënimin e objektit të Sh.M. Institutit për mbrojtjen e përmendoreve kulturore, dhe se bazuar në këtë Ministria e kulturës rinisë dhe sportit, Departamenti i trashigimisë kulturore ka dërguar rekomandimin e komisionit duke cekur se “H. i familjes M.” në ..... nuk ka status të mbrojtjes së përkohshme, pra nuk është pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe se paraprakisht asnjëherë nuk ka qenë i propozuar. Poashtu kanë vizituar edhe lokacionin dhe konsiderohet se ndërtesa është jashtëzakonisht e dëmtuar dhe pothuajse i ka humbur të gjitha vlerat në mungesë të mirëmbajtjes sistematike. Në të njëjtën kohë kanë pranuar edhe një kërkesë nga Komuna e Prizrenit dhe aktvendimin i cili kërkon nga familja M. që ta rrënojnë ndërtesën për shkak se paraqet rrezik për kalimtarët.

Nga raporti i gjendjes faktike të H. të familjes M. të lëshuar nga QRTK me nr. ... të datës 05.12.2014 së bashku me fotodokumentacionin vërtetohet se në bazë të kërkesës së Sh.M. në lidhje me rrënimin e Hanit të vjetër ekipi nga QRTK në përbërje prej drejtorit S.H. , B.P. për arhitekturë J.Gj. dhe F.T. kanë dalur në vend të ngjarjes për të verifikuar gjendjen faktike të ndërtesës që gjendet brenda zonës së Qendrës historike të Prizrenit. Hani nuk është i evidentuar si monument kulture asnjëherë deri më tani, derisa gjendja e tij e vështirë me vite të tërë ka bërë që institucionet përkatëse të kenë njëfarë doze skepticizmi nëse duhet futur në listë ose jo nga se pritej që ndërtesa mund të rrëxohet çdo moment.Pas opservimit vizuel nga brenda dhe jashtë është konstatuar se gjendja statike e ndërtesës është jo stabile dhe paraqet rrezik për kalimtarët e rastit si dhe për banorët që kalojnë nëpërmjet hanit. Nëse analizohet në mënyrë statistikore atëherë del se mbi 80% e ndërtesës është dëmtuar në mënyrë joreverzibile (dëmtime të pakthyesshme) që do të thotë se ndoshta 20% e elementeve të ndërtesës mund të renovohen dhe përforcohen. Nëse mendohet për opcionin e intervenimit emergjent në parandalimin e shkatërrimit total të “Hanit” atëherë mund të thuhet se është tepër vështirë për tu realizuar pasi që shumica e lëndëve të drurit janë tërësisht të kalbura, derisa muret e holla prej qerpiqi janë shpërlarë dhe janë të plasaritura nga lagështia. I vetmi opcion është rindërtimi mbi 80% të ndërtesës, që nuk është e arsyeshme, e aqë më tepër kur nevojiten shuma të konsiderueshme parash. Duke marrë parasysh të lartëcekurat është e pamundur që të shpëtohet kjo ndërtesë, si dhe duke pasur parasysh jetën e njerëzve që çdo ditë janë në rrezik të vazhdueshëm e aqë më tepër

kur tani më kemi hyrë në stinën e dimrit dhe një borë mund të ketë pasoja fatale. Raportit i janë bashkangjitur edhe fotografitë e pamjes së hanit nga të cilat shihet se qatia është e rrënuar, korridori në katë thuaja se është tërësisht i shkatërruar, dhoma në katë në anën verilindore është e rrënuar, dhoma në anën jugore në katë është tërësisht e shkatërruar, shkallët për në katë janë në gjendje të mjerueshme, korridori në kat tërësisht i shkatërruar, dhoma e hangjiut në përdhese pak “më e ruajtur”.

Nga aktvendimi i QRTK me nr. ... / . të datës 14.04.2015 vërtetohet se investitorit Sh. M. pas miratimit të kërkesës respektivisht rekomandimit të Ministrisë së kulturës rinisë dhe sportit të datës 10.04.2015 nr. .. / .. / .... i ipet pajtimi për procedurë të mëtutjeshme, që ka të bëjë me kërkesën nga investitori për pastrimin e ndërtesës së rrënuar.

Nga aktpërcjellja e DUPH me nr. .. - ... - ..... e datës 17.06.2015 vërtetohet se nga Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është dërguar në kompetencë këshillit për trashigimi kulturore lënda e Sh.M. dhe është kërkuar që pas shqyrtimit të kërkesës lënda së bashku me mendimin e këshillit të kthehet në DUPH me qëllim të vazhdimit të procedurave të mëtejme.

Nga njoftimi i QRTK i datës 06.08.2015 së bashku me fotodokumentacionin vërtetohet se me datën e cekur ekipi nga QRTK në përbërje prej B.P. për arkitektur F.T. , etnologe Sh.Sh. dhe orijentaliste M. F. pas daljes në teren kanë vërtetuar se ndërtesa ka humbur të gjitha vlerat dhe si e tillë nuk ka patur status të mbrojtjes së përkohshme.

Nga fotokopja e certifikatës së Agjensisë katastrale të Kosovës P-.....-..... - . e datës 04.12.2014, Njësija katastrale në Prizren vërtetohet se parcela me numër të lartëcekur evidentohet si pronë shoqërore në sipërfaqe prej 666 m2., 423 m2, oborr dhe 243 m2.shtëpi.

Nga fotokopja e kopjes së planit për parcelën ku ka qenë shtëpia dhe H. i familjes M. me nr. ... - .... të datës 04.12.2014 vërtetohet se objekti është shtëpi në sipërfaqe prej 2.43 ari dhe oborr 4.23 ari shfrytëzues E.I. . L.M. , S.M. , E. M., B.M., M.M., Sh.M. , S.M.1 , N.M.2, N.M.1, M.M.1, N.S. .

Nga kontrata mbi shitblerjen e palutshmërisë LRP nr. ..../.. , Ref.nr. ..../.. e datës 15.07.2015 vërtetohet se është lidhur kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë në mes të shitësve Sh.M., E.I., I.M., Sh.M., N.M., N. M., S. M. M. M. dhe E.M. dhe blerësit A. B..

I akuzuari N. M. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në sektorin e inspektorit të inspekcioneve punon prej vitit 2006 dhe se në rastin kontestues ka qenë i caktuar që ta bëjë inspektimin kolegu i tij E. B. dhe se më datën 06.08.2015 e ka thirrë drejtori dhe i ka informuar që duhet që të shkojnë në vendin e ngjarjes. Kur ka mbërritur aty së bashku me kolegun A. B. ishte përfunduar rrënimi i objektit. E ka

përpiluar procesverbalin, ka bërë fotografimin e gjendjes dhe pasiqë investuesi nuk ka prezentuar dokumentacionin ia ka shqiptuar një dënim mandator prej 500 Euro, por tjetër veprim nuk ka ndërmarrë pasiqë objekti ishte i rrënuar dhe pala i ka premtuar që dokumentet do të ia sjellë në zyre. Përpos që i ka shqiptuar dënimin mandator nuk e ka bërë vendosjen e shiritit as nuk ka marrë vendim për ndërprerjen e rrënimeve pasiqë objekti ka qenë veq i rrënuar.

I akuzuari R. M. në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i kujtohet kërkesa të clën e ka paraqitur Sh. M. dhe se dokumentacioni nuk ka qenë plotësisht i plotësuar përpos parashtrimit të kërkesës në sportel e pastaj një aktvendim nga Drejtorati i inspektoratit për rrënimin e objektit që e ka nxit që të konstatoi se rasti është pak urgjent. Ka kompletuar dokumentacionin shtes të nevojshëm dhe e ka inicuar rastin në organet përgjegjëse për marrjen e pëlqimeve të caktuara, pasiqë dokumentacioni nuk ka qenë komplet. Duke marrë parasysh që objekti ka paraqitur rrezik për kalimtarët, pasiqë brendia e tij ka qenë totalisht e rrënuar, jashtë praktikës, të njejtën ditë lënda është dërguar në Institutin për mbrojtjen e monumenteve – tash quhet QRTK – Qendra rajonale e trashigimisë kulturore ku theksohet në paragrafin e fundit që pas shqyrtimit të lëndës, lënda të kthehet në Drejtorinë e urbanizmit për vazhdimin e procedurës së dhënjes së lejes për rrënim. Në afatin ligjor nuk kanë marrë përgjigje dhe se përgjigjen e kanë marrë më datën 10.04.2015. Nëpërmjet kolegëve në Institutin për mbrojtjen e monumenteve ka kuptuar se lënda e M. është tërhjek me vetdëshirën e palës N. M., pasiqë është bërë shit-blerja e pronës e që përsëri në bazë të fotokopjeve të dokumentacionit e ka formuar përsëri lëndën dhe sipas praktikës e ka përcjellë në këshillin për trashigimin kulturo-historike dhe se për shkak të mos funksionimit të këtij këshilli edhe sot e kësaj dite nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje. Poashtu ka shtuar se në rastin e M. ka patur vonesë ligjore – përgjigje prej gadi 5 muajve dhe se zakonisht presin që të vjen përgjigja dhe nuk veprojnë asgjë dhe se kjo ka qenë praktika dhe vendimi i drejtorit për urbanizëm dhe mbikëqyrësve të tij pasiqë i njeiti është vetëm bashkëpunëtor dhe se në këto raste duhet patjetër që të pritët përgjigje nga instituti. Për këtë arsye edhe nuk ka lëshuar aktvendim për dhënjen e pëlqimit për rrënim pasiqë nuk ka pasur pëlqim nga Instituti për mbrojtjen e monumenteve në afatin e paraparë ligjor.

Në bazë të lartëcekurave e pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve N. M. dhe R. M. nuk formohen elementet qenësore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KP, pasiqë kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë relevante të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përkundrazi, me administrimin e provave të lartëcekura e të parashtruara nga ana e prokurorisë është vërtetuar pafajësia e të akuzuarëve. Kjo nga fakti se nga shkresa e Ministrisë së kulturës rinisë dhe sportit, Departamenti i trashigimisë kulturore vërtetohet se H. i familjes M. në Prizren nuk ka status të mbrojtjes së përkohshme, pra nuk është pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të



përkohshme dhe se paraprakisht asnjëherë nuk ka qenë i propozuar. Poashtu, edhe nga raporti i gjendjes faktike të H. të familjes M. të lëshuar nga QRTK me nr.242 të datës 05.12.2014 së bashku me fotodokumentacionin vërtetohet se Hani nuk është i evidentuar si monument kulture asnjëherë deri më tani dhe se pas opservimit vizuel nga brenda dhe jashtë është konstatuar se gjendja statike e ndërtesës është jo stabile dhe paraqet rrezik për kalimtarët e rastit si dhe për banorët që kalojnë nëpërmjet hanit dhe se mbi 80% e ndërtesës është dëmtuar në mënyrë joreverzibile (dëmtime të pakthesshme) që do të thotë se ndoshta 20% e elementeve të ndërtesës mund të renovohen dhe përforcohen. Raportit i janë bashkangjitur edhe fotografitë e pamjes së hanit nga të cilat shihet se qatia është e rrënuar, koridori në kat thuaja se është tërësisht i shkatërruar, dhoma në kat në anën verilindore është e rrënuar, dhoma në anën jugore në katë është tërësisht e shkatërruar, shkallët për në kat janë në gjendje të mjerueshme, koridori në kat është tërësisht i shkatërruar, dhoma e hangjiut në përdhese pak “më e ruajtur”.

Poashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit N. M. gjykata ka vërtetuar se të njëjtit janë ftuar nga ana e inspektionit për rrënim të objektit, pasi që objekti në fjalë paraqet rrezik për kalimtarët, e që kjo deklaratë e tij është në përputhje edhe me provën materiale-aktvendimi i Inspektoratit komunal i Drejtorisë së inspektorateve të Komunës së Prizrenit me nr.17-355/l65734 të datës 26.11.2014, me të cilin i është urdhëruar që në afatin prej 15 ditëve ta bëjnë rrënimin e tërësishëm të objektit-hanit të vjetër për shkak të amortizimit të objektit, se është gjysëm i rrënuar dhe se paraqet rrezik për kalimtarët e rastit dhe banorët fqinj.

Deklaratës së dëshmitarit gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që përputhet edhe me provat tjera të lartëcekura, raporti i gjendjes faktike të H. të familjes M. të lëshuar nga QRTK me nr.242 të datës 05.12.2014 së bashku me fotodokumentacionin, si dhe nga rekomandimi i Ministrisë së kulturës rinisë dhe sportit, dërguar Departamentit të trashigimisë kulturore në Prizren, duke cekur se “H. i familjes M.” në Prizren nuk ka status të mbrojtjes së përkohshme, pra nuk është pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe se paraprakisht asnjëherë nuk ka qenë i propozuar.

Andaj, edhe në këtë drejtim janë të pabaza pohimet e akuzës se këtu të akuzuarit me veprimet e veta kanë dëmtuar edhe trashigiminë kulturore e arkitektonike të mbikëqyrur nga Zyra e Qendrës historike të Prizrenit, pasi që objekti në fjalë asnjëherë nuk ka patur status të objektit të mbrojtur.

Konformë nenit 422 par.l. të KP personi zyrtar i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tija me qëllim që të përfitoi çfarëdo dobie për vehte ose për personin tjetër apo që ti shkaktoi dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër kryen veprën penale të lartëcekur për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej 6 muajë deri në 5 vjetë.

Në rastin konkret nuk është provuar me asnjë provë relevante se këtu të akuzuarit N. M. dhe R. M. me veprimet e veta të kenë përfituar çfarëdo dobie për vehte apo për personin tjetër, apo që të kenë shkaktuar dëm personit tjetër ose që seriozisht ti kenë shkel të drejtat e personit tjetër,ashtu siq parashohin dispozitat e nenit të lartëcekur.Nëse mirret parasysh fakti se “H. i M.” kurrë nuk ka patur status të mbrojtjes së përkohshme, pra nuk është pjesë e listës së trashigimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe se paraprakisht asnjëherë nuk ka qenë i propozuar, si dhe faktin se 80% e objektit ka qenë i rrënuar dhe se ka qenë rrezik për kalimtarët,për çka edhe vet Inspektorati komunal i Drejtorisë së inspektorateve të Komunës së Prizrenit ka urdhëruar rrënimin e objektit në fjalë, atëherë në rastin konkret veprimet e të akuzuarëve nuk mund të inkriminohen dhe të konsiderohen veprime inkriminuese me të cilat veprime do të formoheshin elementet e veprës penale të lartëcekur.

Vepra e lartëcekur penale kryhet vetëm me dashje,pasiqë për egzistimin e kësaj vepre penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin çfarëdo përfitimi material apo jomaterial,shkaktimi i dëmit një personi tjetër ose që seriozisht ti shkelen të drejtat e personit tjetër,që do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale pa u vërtetuar dashja,e që kjo në këtë rast nuk është provuar.

Andaj, në mungesë të provave që do ta vërtetonin faktin e fajësisë së të akuzuarve,pasiqë një gjë e tillë nuk është provuar me asnjë provë relevante dhe bindëse, gjykata morri aktgjykim lirues dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarëve formohen elementet qenësore të veprave penale për të cilat janë akuzuar në bazë të aktakuzës.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 454 par.1 të KP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**Më dt.03.04.2017.P.nr.118/16**

**Proçesmbajtësja**  
**Ardiana Reshtani**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Ajser Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet kësaj gjykate.